

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Taulant Balla jam", dy të rinjtë tentuan t'i merrnin Dukës 100 mijë €, por ranë në pranga
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1394626.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 12:05:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	28 shtator 2026, 12:01:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 28 shtator 2026, 12:00:00 UTC → 28 shtator 2026, 12:02:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	389eda7baa3af6138f5dc97dbabd22e065c7ade516d932b6481ebf8a4098d963
TEKSTI	055aaeb4e028f0feaaec7ef66dbfcf812ec5601b9d9f54aba170105302bcef96
PAMJA	f9e926cc4e20daee3901cd0aac6ec824d7473b924c94798ab9db74cc6265c5d3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	75d760eec9ca147ebd4fa6cacb1a56b88782ef30b73a83243fb1eae299742dc2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	37c1183d944b9abe724532469e5e873d69da6740426bb5bc7e8618c3c9fa36bf
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/75d760eec9ca147ebd4fa6cacb1a56b88782ef30b73a83243fb1eae299742dc2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

“Taulant Balla jam”, dy të rinjtë tentuan t'i merrnin Dukës 100 mijë €, por ranë në pranga

Shkruar nga: I Cani | Publikuar më: 28.09.2026, 14:01



Share



Share



Edison Korra, 24 vjeç, dhe Orest Balla, 23 vjeç, janë dy të rinjtë foto, protagonistët e një tentative mashtrimi me vlerë 100 mijë euro ndaj presidentit të FSHF-së, Armand Duka.

Çdo gjë ka nisur në platformën e enkriptuar “Signal”. Dy të rinjtë janë prezantuar me emrin e Taulant Ballës dhe kanë kërkuar që shuma e konsiderueshme prej 100 mijë eurosh t'u kalohej në formë kriptomonedhash, një taktike e njohur kjo për të shmangur gjurmimin e parave.

Por skema nuk funksionoi sipas planit. Duka, duke dyshuar te mesazhet e marra, i është drejtuar Policisë së Shtetit. Kjo e fundit ka ngritur menjëherë një operacion të kontrolluar për të dokumentuar ngjarjen me prova.

Për të vijuar komunikimin pa ngritur dyshime, u pretendua se me procedurat e kriptovalutave do të merrej djali i Dukës, rol i cili në të vërtetë u mor përsipër nga një agjent i infiltruar i policisë. Agjenti ndryshoi rrjedhën e bisedimeve, duke u komunikuar të dyshuarve se shuma prej 100 mijë eurosh nuk do të jepej në krypto, por vetëm në para cash.

Të rinjtë kanë pranuar kushtin dhe kanë caktuar si pikë takimi për dorëzimin fizik të parave qytetin e Elbasanit, ku edhe banonin. Në momentin e dorëzimit, ndërhyrja e forcave të rendit ka çuar në arrestimin e tyre në flagrancë.

Pas prangosjes, as Korra dhe as Balla nuk kanë dhënë deklarata të hollësishme lidhur me organizatorët të tjerë të mundshëm. Sidoqoftë, burime nga grupi hetimor bëjnë me dije se pistat e hetimit janë përqendruar te Florian Gjergji, ndonëse ky mbetet vetëm një dyshim në verifikim e sipër dhe jo një fakt i provuar ligjërisht. Hetimet për rastin vazhdojnë.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME



Më të Lexuarat



Alliance për
Media
Ethics

ARTIKULL JOETIK?

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!

Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.